KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Informim javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative
Nr. 42/2026
Hagë, 19/11/2026

Përditësim për shtypin

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore të *Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, Trupi Gjykues udhëzoi Zyrën Administrative të organizonte një vizitë nën ruajtje në Kosovë për Jakup Krasniqin për arsye humanitare bindëse.

Kjo është vizita e pesëmbëdhjetë e tillë nga një i paraburgosur në Kosovë deri më sot, urdhëruar nga gjykatësit e Dhomave të Specializuara për arsye humanitare dhe organizuar nga gjykata.

Miratimi për vizita nën ruajtje jepet mbi bazën e rregullës 56 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të DHSK-së e cila u miratua nga gjykatësit dhe bazohet në të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përfshirë nenin 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Rregullat Standarde Bazë të Kombeve të Bashkuara për Trajtimin e të Burgosurve.

Kur një i paraburgosur parashtron një kërkesë të tillë, gjykatësi ose gjykatësit e angazhuar në çështjen gjyqësore i vlerësojnë të gjitha rrethanat ekzistuese në kohën e paraqitjes së kërkesës, me urgjencën dhe dhembshurinë që kërkohet në situata të tilla. Ata e marrin vendimin sipas kornizës juridike të DHSK-së dhe normave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 17 dhe 18 nëntor 2026, Trupi Gjykues urdhëroi të bëheshin publike versionet me më pak redaktime të transkripteve të dy dëshmitarëve të thirrur nga Prokuroria dhe të 6 dëshmitarëve të thirrur nga Mbrojtja gjatë gjykimit.

Megjithëse dëshmia e shumicës së dëshmitarëve të Mbrojtjes u dha në seancë publike, versionet me më pak redaktime të transkriptit përmbanin disa pjesë të seancave gjyqësore që u mbajtën në seancë private. Ky urdhër ishte në vijim të vendimeve të mëparshme të Trupit Gjykues për t'i bërë publike dëshmitë fillimisht konfidenciale të 59 dëshmitarëve.

Këto vendime pasqyrojnë karakterin publik të procesit dhe përkushtimin e gjykatësve për transparencë. Gjatë gjykimit për krime lufte *Thaçi dhe të tjerët*, shumica e dëshmitarëve dhanë dëshmi tërësisht ose kryesisht në seanca publike dhe 61 dëshmitarë dhanë dëshmi pa masa mbrojtëse.

Dëshmitë e dëshmitarëve që fillimisht ishin konfidenciale rishikohen në mënyrë që sa më shumë dëshmi të bëhen publike më pas, duke garantuar njëkohësisht mbrojtjen në vijimësi të viktimave dhe dëshmitarëve. Transkriptet dhe videot e seancave publike mund të gjenden në faqen e internetit të DHSK-së, ku janë të organizuara sipas datës së seancës, ose në kanalin e Gjykatës në *YouTube*.

P.O. Box 47 | 2501 CA, The Hague | The Netherlands | ëëë.scp-ks.org | T +31 (0)6 249 21 036

Ndiqni përditësimet e DHSK-së në faqen tonë "**Aktuale**", në profilet **Twitter** dhe **Instagram** si dhe në kanalin **Youtube**

Për të marrë pjesë në informimet javore të DHSK-së, ju lutemi kontaktoni në MediaKSC@scp-ks.org. *Për informacione të mëtejshme rreth mbrojtjes së të dhënave personale në Dhomat e Specializuara të Kosovës, shihni në* https://ëëë.scp-ks.org/sq/njoftim-privatesine

Informim javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative
Nr. 42/2026
Hagë, 19/11/2026

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 13 nëntor, Administratorja dorëzoi njoftime me shkrim për Trupin Gjykues dhe Panelin e Apelit në lidhje me miratimin e z. Rasëll Hopkins si bashkëmbrojtës i Kadri Veselit.

Në çështjen gjyqësore *Prokurorja e Specializuar k. Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit*, Gjykatësi i Vetëm për Gjykimin e Çështjes shqiptoi Aktgjykimin më 17 nëntor 2026.

Gjykatësi i Vetëm për Gjykimin e Çështjes konstatoi se z. Thaçi u zbuloi informacion konfidencial për disa dëshmitarë në gjykimin e tij për krime lufte, personave që e vizituan në objektin e paraburgimit në vitin 2023, dhe se përmes vizitorëve u përcolli dëshmitarëve udhëzime se si duhej të dëshmonin në gjykimin e tij për krime lufte. Të bashkakuzuarit e z. Thaçi në këtë çështje gjyqësore ishin persona që e vizituan në objektin e paraburgimit.

Gjykatësi i Vetëm për Gjykimin e Çështjes e shpalli Hashim Thaçin fajtor për tentativë për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, shkelje të fshehtësisë së procedurës dhe mosbindje ndaj gjykatës, për të cilat u dënua me 17 muaj burgim që do të kryhet veças nga dënimi tjetër i shqiptuar për fajësinë e tij në çështjen për krime lufte *Thaçi dhe të tjerët*.

Bashkim Smakaj u shpall fajtor për tentativë për pengim të personave zyrtarë dhe për ndihmë në mosbindje ndaj gjykatës, për të cilat u dënua me 12 muaj burgim. Duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim, Gjykatësi i Vetëm për Gjykimin e Çështjes e konsideroi dënimin të shlyer dhe ai u lirua.

Fadil Fazliu u shpall fajtor për tentativë për pengim të personave zyrtarë dhe për ndihmë në mosbindje ndaj gjykatës, për të cilat u dënua me 12 muaj burgim. Duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim, Gjykatësi i Vetëm për Gjykimin e Çështjes e konsideroi dënimin të shlyer dhe ai u lirua.

Hajredin Kuçi u shpall fajtor për një akuzë për mosbindje ndaj gjykatës, për të cilën u dënua me kusht me një muaj burgim që do të konsiderohet i kryer pas një viti, në qoftë se nuk kryen asnjë vepër tjetër penale sipas Kodit Penal të Kosovës gjatë asaj periudhe.

Isni Kilaj u shpall i pafajshëm në lidhje me akuzat kundër tij.

Gjatë shqiptimit të Aktgjykimit, Gjykatësi i Vetëm për Gjykimin e Çështjes theksoi peshën thelbësore të veprave penale të kryera. Ai theksoi se pengimi i detyrave zyrtare në kuadër të kryerjes së një gjykimi përbën sulm ndaj integritetit të sistemit gjyqësor, që përbën një themel të domosdoshëm për sundimin e ligjit.

P.O. Box 47 | 2501 CA, The Hague | The Netherlands | ëëë.scp-ks.org | T +31 (0)6 249 21 036

Ndiqni përditësimet e DHSK-së në faqen tonë "**Aktuale**", në profilet **Twitter** dhe **Instagram** si dhe në kanalin **Youtube**

Për të marrë pjesë në informimet javore të DHSK-së, ju lutemi kontaktoni në MediaKSC@scp-ks.org. *Për informacione të mëtejshme rreth mbrojtjes së të dhënave personale në Dhomat e Specializuara të Kosovës, shihni në* https://ëëë.scp-ks.org/sq/njoftim-privatesine